



PROTOKOLLI I I VERDHË I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19 TREGJET E HAPURA PUBLIKE

- Sipas rastit Administratori/Personi Fizik Tregtar/Personi Përgjegjës i Autorizuar (këtu e në vijim personi përgjegjës) kryen çdo ditë vetëvlerësimin personal dhe vlerësimin për prezencën e simptomave të COVID-19 në personat e punësuar/tregtarë. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127. Nëse personi shfaq simptoma ndërkohë që është duke punuar apo pas punës, ky person duhet të karantinohet në ambientin e veçuar derisa të merren masat përkatëse nga shërbimet shëndetësore.
- Për çdo rast personi përgjegjës apo përfaqësuesi i entit administrues të tregut lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Institutin e Shëndetit Publik.
- Përfaqësuesi i përcaktuar nga përfaqësuesi i entit administrues të tregut mat temperaturën e punonjësve/tregtarëve dhe të çdo personi tjetër klient në hyrje dhe dalje me termometër infrared dhe njofton menjëherë strukturat përkatëse për temperaturat më të larta se 37,5 gradë në rastet kur ka edhe simptoma të tjera të COVID-19. Asnjë person me temp 37.5 nuk duhet të lejohet të hyjë në subjekt.
- Çdo punonjës/tregtar është i detyruar të deklarojë ndaj përfaqësuesit të entit administrues të tregut nëse ka patur kontakt me persona të cilët rezultojnë apo kanë rezultuar pozitiv me COVID-19.
- Çdo punonjës/tregtar që vëren shenja klinike gjatë qëndrimit në banesë nuk duhet të paraqitet në punë dhe duhet të lajmërojë menjëherë përfaqësuesin e entit administrues të tregut. Punonjësi duhet të telefonojë 127 dhe mjekun e familjes.
- Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar nga dispozitat ligjore.
- Në hyrje-dalje të tregut vendoset nga Bashkia tuneli spray me dezinfektant sipas përqindjes së përbërjes dhe udhëzimeve përkatëse nga prodhuesi/shitësi apo Minsitria e Shëndetësisë. Çdo punonjës apo individ që hyn e del

detyrimisht dezinfektohet në këtë tunel për çdo hyrje-dalje.

- Për qytetarët e moshuar apo me aftësi të kufizuar, këto subjekte mund dhe rekomandohet të ofrojnë sipas mundësisë dërgimin e ushqimeve tek këta qytetarë përmes porosive me telefon apo vizitave derë më derë sipas një programi të caktuar me listë. Në bashkëpunim me komunitetin dhe organet vendore, këto subjekte të evidentojnë banorët në nevojë të cilët nuk kanë anëtarë të familjes së tyre për t`u shërbyer. Ky shërbim të ofrohet pa pagesë. Qytetarëve të moshuar apo me aftësi të kufizuar u shërbehet me përparësi.
- Rekomandohet sa më shumë shërbim delivery në adresë dhe mundësia e blerjes online/telefon.
- Vajtja dhe ardhja në punë në këmbë kryhet duke ruajtur distancën 2 metra dhe jo duke krijuar grupime. Për lëvizjen me automjet/motomjet/kamionë etj. të zbatohen masat e publikuara nga Policia e Shtetit.
- Subjekti tregtar duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment doreza mbrojtëse, maska dhe higjenizues duarsh me mbi 60% alkool për veten dhe punonjësit e tij.
- Personeli i punësuar/tregtari dhe personat e tjerë klientë duhet të përdorin në çdo moment dorezat mbrojtëse.
- Personeli i punësuar dhe personat e tjerë klientë duhet të mbajnë në çdo moment maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën.
- Kollitja dhe tështitja kryhen duke përdorur brrylin apo letër hundësh. Letra hidhet menjëherë në kosh.
- Në hyrje dhe dalje të tregut strukturat e Bashkisë duhet të ofrojnë produktin higjenizues të duarve për klientët dhe të kujdesen për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60% alkool.
- Subjekti tregtar duhet të garantojë dhe respektojë në çdo moment distancën prej 2 metrash midis personelit të punësuar dhe këtyre të fundit e klientëve.
- Subjekti shërben vetëm një klienti, ndërkohë që të tjerët presin në rradhë me distancë 2 metra nga njëri-tjetri. Përballë tezgave vendosen shenjat identifikuese të rradhës dhe shenja identifikuese e distancës klient-arkë.
- Sigjerojme që tregu nuk duhet të shërbejë më shumë se 30 persona në një moment të caktuar. Për këtë strukturat e Bashkisë marrin masat përkatëse për të monitoruar hyrje-daljen dhe rrethimin e tregjeve sipas mundësisë.
- Rekomandohet shmangia e parasë cash dhe ofrimi i shërbimeve të pagesës me kartë krediti.

- Punonjëset e arkës dezinfektojnë duart pas çdo veprimi me cash.
- Subjekti mund dhe rekomandohet sipas mundësisë të vendosë xham mbrojtës (plexiglass) midis punonjësit dhe klientit.
- Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik mes punonjësve apo mes palëve të treta furnizues, shpërndarës etj. përfshirë përshëndetjet.
- Personat e tretë si furnizuesit, shpërndarësit të lejohen vetëm të pajisur me maska dhe doreza mbrojtëse dhe pas dezinfektimit të duarve.
- Gjatë pushimit apo orarit të ngrënies të shmangjet grumbullimi i personave.
- Strukturat e Bashkisë duhet të kryejnë dezinfektim të ambientet dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes. Sipërfaqet e papastra lahen fillimisht me ujë dhe sapun e më pas dezinfektohen me produktet e tjera. Secili punonjës/tregtar kryen dezinfektimin me produktet e higjenes të tavolinave, banaqeve, telefonave dhe çdo hapësire apo objekti ku ka patur kontakt prej në fillim dhe përfundim të turnit/ditës. Produktet përdoren në përputhje me udhëzimet përkatëse nga prodhuesi/shitësi apo Minsitria e Shëndetësisë.
- Punonjësit/tregtarët gjatë punës nuk duhet të përdorin mjetet apo vendin e punës së kolegëve pa kryer dezinfektimin.
- Në hyrje të tregut Bashkia duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas checklistës së miratuar.
- Në hyrje të tregut Bashkia duhet të afishojë posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19 sipas formatit të miratuar.
- Subjekti/tregtar duhet të afishojë deklaratën për zbatimin e protokollit të verdhë për tregjet e hapura, sipas formatit të miratuar ku përfshihet detyrimi për vetëvlerësim të simptomave nga personeli i punësuar/tregtar sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.
- Në hyrje të tregut Bashkia duhet të afishojë të plotë protokollin e verdhë për tregjet e hapura sipas tekstit të miratuar.
- Materialet e mësipërme afishohen në hyrje të tregut nga strukturat e Bashkisë.
- Bashkitë të realizojnë detyrimet përkatëse sipas protokollit të mësipërm.